

BETIM MUÇO

novela e tregime

**MALL
PER
NJEEREZ**

854-32
M/88



8SH-32

193

BETIM
MUÇO

MALL
PËR
NJERËZ

Novela
e
tregime

BIBLIOTEKA E BRETANIS

SHKOLLËS

№ 44632

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

GUR NJË

— novelë —

Asnjëherë nuk e morëm vesh kush e tha i pari atë gjë tronditëse. Rrethanat erdhën të tilla që më pas u interesuam mjaft për zanafillën e saj. Si erdhi te ne, kush e solli, kur u përhap? Po kjo s'ishte e kollajtë. Fijet ndërpriteshin e ngatërroheshin dhe mbetëj ajo që na tronditi aq shumë e na vuri aq vjet në mendime.

Atë kohë në institut flitej shumë për një qar-kullim të kuadrove. Thoshin se hartohëj dhe një listë me të paaftë, që s'ishin në gjendje të ndiqnin ritmet e punës kërkimore — shkencore e të ndihmonin prodhimin ashtu siç duhej. Po këto ishin gjëra të zakonshme, me të cilat ne ishim

mësuar. Dhe ja, pikërisht në këtë valë, pa u ndier e pa u kuptuar, u përhap e zuri vend në jetën e institutit tonë ai lajm që na rrëqethi e na bëri të mbajmë tjetër qëndrim ndaj Hito Dakullës. Në fillim gjithçka thuhej vesh më vesh. Çdo bisedë për të fillonte me habi dhe mbaronte me keqardhje. Ishte e tmerrshme! Nuk dinim në kishte vuajtur Hito Dakulla nga ndonjë sëmundje. Dhe ja, tani... A thua ta kishte marrë vesh ai? Me siguri nuk duhej t'ia kishin thënë. Dhe në të vërtetë, si mund të thuhej kaq kollaj kjo gjë? A mund të punonte më njeriu i shkretë paskëtaj? Jo, ai, me siguri, nuk e dinte. E vërenim me kujdes Hito Dakullën kur shkonte i kërrusur në anë të korridorit, me çantën nën sqetull. Nuk qeshte si më parë. E si mund të qeshte?... Ndodhte që ndonjë nga ne linte punën dhe me sytë nga dritarja thoshte: «Ja, po vjen Hitoja!» Dhe ne ngriheshim, u afroheshim xhamave e shikonim të gjithë bashkë atë ecje, që na dukej aq e mundimshme, të Hito Dakullës. «Ja keni vënë re ngjyrën e lëkurës? — thoshte Lani. — Shikojani me vëmendje. Kjo është shenja e parë. Njeriun e përfshin një zbehtësi e jashtëzakonshme, një lloj çngjyrosjeje që duket sikur shkon drejt transparencës së plotë... Unë i di mirë këto gjëra se m'i ka thënë im kushëri që është specializuar posaçërisht në Vjenë.»

Mbeteshim gojëhapur ku dëgjonim këto. Po si ishte e mundur vallë?! T'i vijë njeriut të shkretë kështu papritur e pakujtuar?!... Dhe përsëri e për-

sëri vështronim me kujdes e marifet Hiton për të vërtetuar fjalët që thoshte Lani. Vërtet, ashtu ishte. Tani Hito Dakulla na dukej i mpakur e i rënë si kurrë ndonjëherë. Flokët i ngjanin të rralluar e të dobët, sikur mund t'i binin nga koka edhe po t'u fryje, kurse zëri sikur i ishte ngjirur e kishte marrë një nuancë të re, që s'ia kishim ndier më parë. Bisedat zienin. Si do t'i vente filli atij njeriu? Ç'mund të bënte mjekësia?... Ndoshta ishte konstatuar shpejt si rast, ndoshta shërohej, ndoshta... Por jo. Lajmi solli lajmin dhe pikërisht në këtë kohë u tha se mjekët ishin dorëzuar dhe e kishin lënë Hito Dakullën në dorë të natyrës. Tani fjala kishte marrë dhenë. Bajo Nerënxa tha se e shoqja e Hitos kishte tërhequr lekët nga librezja e kursimit, kurse një shitëse e lagjes së tyre hapi lajmin se e kishin porositur për copë të zezë. Tani në institut s'mbeti njeri pa e ditur. Ata të sektorëve më të largët na pyesnin ne që ishim më pranë zyrës së Hitos. E ç't'u thoshim ne veç atyre që diheshin? Gratë nduknin faqet dhe kafshonin buzët duke pëshpëritur nëpër dhëmbë atë fjalën mëshiruese: «I shkreti!» Ndoshta i vetmi që s'e dinte tani këtë mynxyrë ishte vetë Hito Dakulla. Ai sillej ashtu si më parë. I qetë, i pandjeshëm, pak i shoqërueshëm e që shihte punën e vet. Veçse gjithkush nga ne, çdo ditë që shkonte, i vinte re ndonjë shenjë të re, që bëhej përnjëherësh objekt bisede. Dikush tha se Hito Dakulla pshorëinte më shpesh tani, me një rënkim të thellë kraharori që sikur i dilte nga fundi i shpirtit. Mos vallë

e dinte?.. Jo, jo, në asnjë mënyrë. Nuk kishte se si ta dinte. Dhe, bile, ne të gjithë duhej të tregoheshim shumë të matur e të kujdesshëm, që ai ta merrte vesh sa më vonë atë gjë.

Këto bisedonim në intervalet mes punëve, në kafe, në zyra e në korridore dhe këto biseda ishte e natyrshme që na i fashitnin për ca çaste buzëqeshjet e na bënë të tundnim kokat me dhimbje. Pastaj llafi nxirrte llafin dhe sekush përmendte ndonjë rast të tillë që dinte a që kishte dëgjuar. Por për ato ne flisnim si për njerëz që s'i njihnim e që s'kishin të bënë me ne, kurse Hito Dakullën e kishim përditë në mes tonë dhe fatkeqësia e tij na bënte të kujtonim se sa i pamëshirshëm është ndonjëherë fati, sa mizor e i paevitueshëm. Se ja, në vënd të Hitos mund të ishte njëri, një tjetër, a një tjetër nga ne...



Sigurisht që Hito Dakulla u hoq nga lista e të paaftëve. Ishte absurde të mendoje të kundërtën. Edhe më zemërgurët u tërhoqën e lëshuan pe. Fundi i fundit, ai ishte përpjekur me sa kishte mundur për atë institut. Kishte qenë nga themeluesit e tij. Edhe i ri tashmë nuk ishte, pesë — gjashtë vjet i mbeteshin të dilte në pension, (atë pensionshkretin që, me sa dukej, s'do

ta gëzonte kurrë!) Pastaj... në këtë gjendje që ndodhej ai tani... Ishte e kuptueshme... A ishte ai për të filluar një punë të re? As që bëhej fjalë. Në mbledhjet që u bënë askush nga ne nuk e ngacmoi emrin e tij. E si mund ta ngacmonim ne?! A nuk mjaftonte ai ngacmim mizor i natyrës, ai short i lig që atij i kishte rënë për hise (dhe përsëri mendonim që në vend të tij mund të kishte qenë secili prej nesh!), ajo sëmundje ndaj së cilës njeriu ishte i pafuqishëm? Vetëm emrin t'i zije në gojë, të dridhej qimja e flokut gjer thellë në rrënjë. Dhe jo më pastaj të mendoje se ajo kishte bërë fole te ti, përhapej e përhapej tinzare, e pandier dhe bëhej gati të shtrinte në tërë trupin ato që çdokush i përfytyronte si ca tentakula të frikshme oktapodi.

Po ku vallë e kishte atë Hito Dakulla? Në mëlçi, në zorrë, në stomak? Lani ngulte këmbë se e kishte në mushkëri. Të tjerë e kundërshtonin. Po ta kishte në mushkëri, thoshin ata, do të kishte mbaruar me kohë, se në mushkëri ajo marrka formë galopante. Me siguri, thoshin, do ta ketë në organet e tretjes. Nuk e shihni si është dobësuar e i varen rrobat në trup?... Edhe kafet i ka rralluar, e keni vënë re? Po Lani nuk tërhiqej. Ai sillte si argument frymëmarrjen e shpeshtuar e të zëshme të Hito Dakullës dhe një kollë që ia kishim rdiar ca më shpesh këto kohët e fundit. Dhe, sigurisht, ai i përfundonte fjalët e tij duke iu referuar kushëririt të tij

specialist. Kur qëllonte që i dëgjonte të gjitha këto, Bajo Nerënxa vetëm heshtte e tundte kokën me një okë mërzi. Po të, mor Bajo, i thoshim ne, po ti si mendon? Po Bajo Nerënxa ncukte përsëri buzët e thoshte: «Eh, i varfri Hito! Kudo ta ketë, ky behar nuk e zë». Dhe tundte kokën me sytë gjysmë të mbyllur. I ulte sytë dhe drejtori ynë sa herë që binte fjala për Hito Dakullën. Me marifet ai u interesua që Hitoja të lehtësohej pakëz nga puna. Dhe bëri shumë mirë. Disa ditë rresht ne vetëm për këtë flisnim. Secili nga ne, po të ishte në vendin e tij, kështu do të vepronte. Drejtori i kuptonte këto gjëra. Ishte njerëzor. Fundja, me aq sa i kishte mbetur atij fatkeqi, sado punë të bënte, boll ishte për të.

■

Erdhi pranvera. Një mëngjes e pamë Hito Dakullën, ashtu të kërrusur e me çantën nën sqetull, të mbante këmbët pranë hyrjes së institutit dhe të zgjaste dorën drejt luleve që kishin buisur aty në lehet e lulishtes. Qëndroi ca çaste ashtu, me dorën që na u duk se i dridhej, mbi kokat e luleve, që ai fillad mëngjesi ua lakonte kërcejtë e gjelbër e të mbushur me lëng. Na u dhimbs sa s'thuhet atë çast të gjithëve sa e shihnim. Nja dy gra nuk i mbajtën lotët. Dhe

ishte pikërisht ai mëngjes kur morëm vesh se Hito Dakulla e dinte mynxyrën e tij. Pra, e dinte se ç'e priste. As këtë nuk e kuptuam se si erdhi te ne. Nga e mori vesh ai? Kush ia tha? Mjekët, apo njerëzit e familjes? Nuk ishte e mundur. Dikush thoshte se ai e kishte kuptuar nga sjellja e të afërmeve. Një tjetër shkoi më tej. Duke dyshuar se diçka ka, Hito Dakulla qenkësh hequr si i vëllai dhe kishte pyetur në spital për analizat e tij. Një mjek stazhier nuk e paskësh njohur dhe ia paskësh thënë të gjitha: kështu e kështu. Ja si shpjegohej ai mallëngjimi i tij për ato lule të para pranvere. Hito Dakulla sikur po ndahej nga to, sikur po u thoshte se nuk do t'i shihte më kurrë, kurrë. Ky lajm ngjalli një valë të re diskutimesh. Pra ai e dinte ç'e priste. Dhe prapë nuk e jepte veter. Njëlloj si më parë. Kjo ishte për t'u çuditur. Ndieje të të ngjitej në grykë, veç keqardhjes, një diçka tjetër, krenari, vlerësim, respekt për atë njeri që, fundja, ishte shoku ynë. Se nuk ishte kaq e kollajtë që ta dije atë fat dhe t'i bëje ballë aq qetë. Ndonjë tjetër do ta braktiste punën fare e do të zhytej në dëshpërim. Kishim dëgjuar për njerëz që në raste të tilla ishin dhënë pas pijes që të harronin gjithçka, të tjerë ishin bërë mizantropë e s'donin të shihnin njeri me sy, u ngjallej urrejtja për botën gjithë e mbylleshin në vetvete; të tjerë akoma shkonin edhe më tej, gjer në vetëvrasje. Kurse Hito Dakulla asnjë nga

këto nuk bëri. Njëlloj si më parë. Ai që kishim njohur. Kurrë nuk e ngriti zërin e s'u bë nervoz. Dhe të mendoje që, sido që të sillej, do të kishte të drejtë. Po, po, kishte të drejtë të ulërinte mu aty në mes të korridorit dhe askujt nga ne të mos i vinte çudi. Të thërriste: «A, ç'më çani kokën, o njerëz! Shkoni në djall me gjithë punërat tuaja! Nuk e dini ç'po heq unë në këtë të shkretën veten time?!» ... Por ai hiç. Kjo e rriti edhe më figurën e tij në sytë tanë. Por a mjaftonte kjo? Ç'mund të bënim tjetër për të? Si mund t'ia lehtësorim sadopak vuajtjet?.. Meqë tani ai e dinte, na binte edhe neve për detyrë që ta kurajonim me sa mundeshim, të mos e ndiente dhe aq dhembjen, vetminë që shkaktonte zakonisht një sëmundje e tillë në ato ditë të fundit që i kishim mbetur. Mbanim vesh kur kalonte ai në korridor, aty anës murit, i qetë e i pandjeshëm, ashtu si gjithë jetën e tij. Kur dikush arrinte ta pyeste se si ndihej sot, atij i formohej në buzë një qeshje e mundimshme dhe e dëshpëruar, tundte lehtë kokën dhe dora i lëvizte sikur përcillte diçka. Atëherë të pushtonte një valë mallëngjimi e keqardhjeje dhe ishte e pamundur të mos përpiqeshe të kujtoje ku ishin virtytet e atij njeriu, sado të padukshme që të ishin ato. Përpiqeshim të gjenim si kishte vepruar ai në një rast apo në tjetrin dhe ia zbukuronim me sa mundnim situatat e jetuara. E ç'mund të bënim tjetër veçse, të paktën, ta mbanim mend